



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

Përshëndetje

Referuar pyetjeve të shtruara nga ju, bëjme me dije informacionin:

1.A keni ndonjë projekt për ndërhyrje në tregun kryesor të Shkodrës, në lagjen Rus?

Që në ditët e para të punës mas marrjes së mandatit nga kryetari i ri i bashkisë, tregut të Rusit i është kushtuar një vëmendje e vecante. Ashtu sic me te drejte edhe ju keni konstatuar ne shkrimin e muajit mars, gjendja në këtë treg është shumë e rende.

Masat urgjente konsistuan në lirim të trotuareve, futjen e shitësve ambulante brenda zones se tregut, ku u bë pershtatje e mjediseve për tregtim, si dhe regjistrimi i tregtareve. Sezoni veror e temperaturat e larta te ketij muaji e bejne edhe më emergjente nevojen për këto ndërhyrje.

Nga ana tjetër, në tregun e Rusit do të ndërhyhet shumë shpejt me një projekt të dedikuar.

Por ajo që është më e rëndësishme ka të bëjë me faktin se,

Bashkia Shkodër është përzgjedhur fituese për financim në kuadër të thirrjes për propozime të shpallur nga Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural (AZHBR). Me ane te realizimit te këtij investimi ne synojme akomodimin sipas kushteve të favorshme të tregtimit të një numri prej 128 tregtarësh, duke permiresuar kështu kushtet e tregtareve dhe duke rritur kënaqësinë konsumatore të bleresve potencial.

Me shkresën nr. 9414 prot. datë 6.7.2023 të AZHBR, Bashkia Shkodër është shpallur fituese dhe ka pasur detyrimin për të krijuar Sh.a. të menaxhimit të tregjeve, në zbatim të VKM nr. 125 datë 1.3.2023 “për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2023”. Krijimi i kësaj sh.a-je ka kërkuar një angazhim të madh të drejtuesve e specialistëve të bashkisë, të cilët në një kohë rekord,e kanë bërë të

mundur këtë gjë. Gjë që shërben në fakt edhe si pasqyrim i drejtëpërdrejtë i vullnetit për ta kryer këtë ndërhyrje dhe përmirësimin e kushteve të tregjeve në bashkinë e Shkodrës.

Në mbështetje të rregullave të aplikimit, me datë 24.7.2023, në zbatim të VKB nr. 15 datë 20.7.2023 është krijuar shoqëria aksionare **“Bio Strajca”** me objekt:

a) Ofrimi i shërbimeve në fushën e zhvillimit ekonomik për mirëfunksionimin e tregjeve publike dhe rrjetit të tregtisë.

b) Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor dhe ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj komunitetit.

c) Menaxhimi i tregjeve të produkteve bujqësore, tregjeve të kafshëve të gjalla, thertoret etj.

Qëllimi i krijimit të kesaj ndërmarrje të re nuk është vetëm përthithja e Grantit të fituar nga AZHBR, por mbi të gjitha nevoja për një menaxhim më të mirë të tregjeve publike të Bashkisë Shkodër.

Kjo sipërmarrje e re do të sjellë një koncept të ri të menaxhimit të tregjeve, e cila synon mbështetjen e fermerëve lokal dhe bleresve në të gjithë territorin e bashkisë Shkodër, nëpërmjet përmirësimit të kushteve të tregtimit të produkteve bujqësore dhe rritjes së sigurisë ushqimore.

2. Nëse po, kur është planifikuar të nisë investimi në këtë treg?

Po kryhen procedurat administrative për kalimin e fondit nga AZHBR tek llogaria e institucionit Bashkia Shkodër. Pasi fondi kalon tek ne, do kryejmë procedurën e miratimit të investimit në Këshill Bashkiak dhe pastaj mund të fillojmë procesin e tenderimit të këtij fondi për zbatimin e projektit. Sikurse e sqaruam procedurën dhe më sipër, data e fillimit të ndërhyrjes në treg nuk varet vetëm nga ne. Kështu që mund të parashikojmë fillimin e investimit në fund të muajit Shtator apo fillimi i muajit Tetor 2023.

3. Sa do të jetë vlera e investimit për tregun në Rus?

Vlera totale e investimit per nderhyrjen e parashikuar sipas projektit ne Merkaton Rus eshte 36,036,583 me tvsh, ku mbeshtetja me Grant nga AZHBR eshte 29,155,812 Lek, ndersa Bashkia Shkodër për realizimin e këtij investimi do të marrë përsipër mbulimin e vleres së TVSH dhe fondit Rezerve në vlerat:

Fond Rezerve: 874.674.36 Lek

TVSH: 6,006,097 Lek

4.Sa tregtarë tregtojnë aktualisht në këtë treg?

Aktualisht në këtë treg ushtrojnë aktivitetin e tyre një numër prej 52 tregtaresh, të cilët kanë të miratuar lejen për shfrytëzim hapësire publike në Merkaton Rus për vitin 2023.

**KRYETAR**

**Benet Beci**